



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:069399

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06403006

KPPP.nr.424/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Pro Credit Bank” SH.A., me numër unik identifikues 811186487, me seli në Kosovë, rr. “Xhorxh Bush” nr.26, kundër debitorëve “O&D” Group SH.P.K., me seli në Lipjan rr. “Ruzhdi Shabani” nr.431 përfaqësuar nga A.D., sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arian Prebreza, A.D. nga Prishtina me adresë në rr. “...”, K.B. nga fshati ... Komuna e Lipjanit dhe “Staract” SH.P.K., me numër unik identifikues 811345364, me seli në Fushë Kosovë, sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arian Prebreza, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit e të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka me seli të zyrës në Prishtinë, me datë 28.10.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitorët “O&D” Group SH.P.K. dhe A.D., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.
- II. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm, prapësimi i debitorëve “O&D” Group SH.P.K. dhe A.D., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka,
- III. LEJOHET kthimi në gjendjen e mëparshme për shkak të mos ruajtjes së afatit për ushtrimin e prapësimit të debitorëve “Staract” SH.P.K. dhe Kushtrim të paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.

IV. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorëve Staract” SH.P.K. dhe K.B. ashtu që Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 2054/23 i datës 19.12.2023 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Valdrin Beka MBETE NË FUQI

#### A r s y e t i m

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Pro Credit Bank” ka lëshuar Urdhrit Përmbarrimor P.nr.2054/23 të datës 19.12.2023, me të cilin e ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrues Kontratën Kornizë të Kredisë për Biznes Nr. FW 10.1632, Kontratën e Hipotekës LRP-nr.85/2022 dhe Ref.nr.85/2022 mbi bazën e së cilës është nxjerr Aktvendimi mbi Regjistrimin e Hipotekës Nr.ref. 02-175/2022 si dhe Kontrata e Pengut Nr. FW.10.1632 e datës 02.03.20022 si dhe dhe Kontratën Kornizë të Kredisë për Biznes Nr. FW 10.1665, Kontratën e Pengut Nr.FW 10.1665 të datës 02.03.2022 si dhe Konfirmimi i Regjistrimit R-20220302-415 me të cilin ka detyruar debitorët që të shlyej obligimin në lartësi prej 44,645.70€, përmes bllokimit të llogarive bankare dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme.

Përmbarruesi Privat përmes postës elektronike me datë 14.02.2024 i ka dërguar debitorit A.D. përfaqësues i debitorit “O&D” Group SH.P.K., propozimin për përmbarrim duke kërkuar nga i njëjti konfirmimin për pranimin e emailit.

Debitori A.D. përfaqësues i debitorit “O&D” Group SH.P.K., përmes postës elektronike në të njëjtën datë ka konfirmuar pranimin e emailit.

Debitorët “O&D” Group SH.P.K., A.D., K.B. dhe “Staract” SH.P.K., me datë 26.02.2024 kanë paraqitur propozim për rikthim në gjendjen e mëparshme, përmes së cilës kanë kërkuar nga gjykata që t’ua mundësoj rikthimin e afatit për paraqitjen e përgjigjes në prapësim, me arsyetimin se Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Valdrin Beka e kanë pranuar përmes emailit, mirëpo meqenëse emaili ka pasur 10 fajlla, dhe në fajllin e 10 ka qenë propozimi, tek i cili çuditërisht nuk e kanë vërejtur këshillën juridike. Andaj meqenëse dorëzimi është bërë përmes postës elektronike dhe jo postës së rregullt i ka propozuar gjykatës që të lejoj kthimin në gjendjen e mëparshme.

Debitorët, përmes prapësimit kanë kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet për përmbarrim meqenëse dokumenti mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbarrimore nuk përbën titull ekzekutiv. Theksojnë se urdhri nuk mund të përmbarrohet pasi që kreditori nuk ka provuar fillimisht të lidh ndonjë marrëveshje me debitorët.

Gjykatës i kanë propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorëve “O&D” Group SH.P.K., A.D., K.B. dhe “Staract” SH.P.K., si dhe të abrogohen veprimet e ndërmarra ndaj debitorëve. Po ashtu kanë kërkuar shpenzimet e rpecedurës në emër të përpilimit të prapësimi.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur kreditori, i cili ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke shtuar se pretendimet e debitorëve të paraqitura në prapësim nuk qëndrojnë. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve dhe ta vërtetoj Urdhrin Përmbarrimor P.nr.2054/23 të datës 19.12.2023.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se kërkesa e debitorëve “O&D” Group SH.P.K. dhe A.D. për rikthim në gjendje të mëparshme është e pabazuar dhe prapësimi i ushtruar nga ta është i pa afatshëm, ndërkaq lejoji kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të mos ruajtjes së afatit për ushtrimin e prapësimi të debitorëve K.B. dhe “Staract” SH.P.K., dhe prapësimin e ushtruar nga ta e refuzoi si të pabazuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsytet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorëve “O&D” Group SH.P.K. dhe A.D., për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimi është e pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas dispozitës ligjore të nenit 103 par. 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se *“103.2 Dërgimi mund të bëhet nëpërmjet postës elektronike. Në rast të këtillë, konsiderohet se është kryer dorëzimi i shkresës në momentin kur është dërguar nëpërmjet postës elektronike.”*.

Gjykata, pas vlerësimit të shkresave të lëndës gjeti se debitori ka pranuar urdhrin për lejimin e përmbarrimit me datë 14.02.2024 përmes postës elektronike dhe po në të njëjtën datë debitori A.D., i cili në këtë procedurë ka cilësinë e debitorit dhe përfaqësuesit të “O&D” Group SH.P.K..

Andaj sipas vlerësimit të gjykatës, për debitorët “O&D” Group SH.P.K. dhe A.D. është bërë dorëzimi me rregull i Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023 me datë 14.02.2024 ku rezulton se debitori ka pasur afat shtatë (7) ditë që të ushtroj mjetin juridik të prapësimi, në kuptim të nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore me të cilin përcaktohet se: *“Prapësimi*

*duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”, dhe se data e fundit e paraqitjes së prapësimit ka qenë 21.02.2024.*

Andaj meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 26.02.2024, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me pesë (5) ditë vonesë.

Mbi këtë bazë, e në kuptim të nenit 73, par. 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”* gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pa afatshëm.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorëve “Staract” SH.P.K. dhe K.B. për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit është bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstatoi se debitorët nuk e kanë pranuar në mënyrë të rregullt propozimin për përmbarim dhe urdhrin përmbarimor konform dispozitave ligjore në fuqi, ngase nga shkresat e lëndës, nuk ka prova se debitorët kanë pranuar në çfarëdo forme Urdhrin Përmbarimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023.

Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitivin II të këtij Aktvendimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 68 par. 2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.”* dhe në nenin 67 paragrafin 1 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: Prapësimi dhe Ankesa.”*

Andaj, meqenëse nuk ka prova se përmes komunikimit elektronik Përmbaruesi Privat i ka dërguar debitorëve Staract” SH.P.K. dhe K.B. Urdhrin Përmbarimor P.nr. 2054/23 të datës 19.12.2023, gjykata lejoi kthimin në gjendje të mëparshme dhe trajtoi prapësimin e debitorëve në merita.

Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjeti se prapësimi i debitorëve Staract” SH.P.K. dhe K.B. është i pabazuar, për arsyet në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbaues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbauesin vetëm në bazë të dokumentit përmbaues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22, par. 1.7 përcaktohet se *“1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”* kurse me nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore përcaktohet se dokument përmbaues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*.

Gjykata duke vlerësuar Kontratën e Hipotekës LRP-nr.85/2022 dhe Ref.nr.85/2022 gjeti se e njëjta është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht në shkresa të lëndës është bashkangjitur kopja e vërtetuar me akt noterial dhe i është bashkangjitur Aktvendimi mbi Regjistrimin e Hipotekës Nr.ref. 02-175/2022, andaj gjykata vlerëson se urdhri i lejuar mbi bazën e kësaj marrëveshje është në përputhje me nenin 38 par. 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *1. Propozimi për përmbaues duhet ta përmbajë kërkesën për përmbaues në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaues origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbauesi, kërkuesi i përmbauesit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbauesi, objekti i përmbauesit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbauesit.”*.

Gjykata duke vlerësuar Kontratën e Pengut Nr. FW.10.1632 të datës 02.03.20022 si dhe Kontratën e Pengut Nr. FW 10.1665 të datës 02.03.2022 të nxjerra konform dhe Kontratës Kornizë të Kredisë për Biznes Nr.FW 10.1665 gjeti se të njëjtat janë paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht janë bashkangjitur shkresave të lëndës kopje të noterizuara, siç përcakton neni 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përmbaues duhet ta përmbajë kërkesën për përmbaues në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaues origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbauesi, kërkuesi i përmbauesit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbauesi, objekti i përmbauesit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbauesit.”*.

Në këtë drejtim, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbaues ose urdhri përmbaues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare*

*të përmbarueshmërisë*” gjykata erdhi në përfundim se urdhri për lejimin e përmbarimit duhet të mbes në fuqi, pasi që dokumentet mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi, i plotësojnë kushtet për të qenë titull ekzekutiv.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në Kontratën e Hipotekës LRP-nr.85/2022 si dhe Kontratës së Pengut Nr.FW.10.1632 të datës 02.03.20022 dhe Kontratës së Pengut Nr.FW 10.1665 të datës 02.03.2022, të cilat përbëjnë dokument përmbarimor dhe i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit në prapësim, se dokumentet në bazë të së cilave është lëshuar urdhri përmbarimor nuk kanë titull ekzekutiv ose nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se dokumentet e lartcekura i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të përmbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.424/24, datë 28.10.2024

Gjyqtari  
Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.